



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raportit mesimdhënës nxënës. Vendimit të MASH-it, nr.01/3-70, të datës 07.08.2020, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

-IV- Nr. i prot. 346 Më Dt. 14.08 2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021
(afati i gushtit)

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollës profesionale, për vitin shkollor 2020/21, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet në datat, 17, 18, 19, 20 dhe 21 gusht 2020 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën, 24 gusht 2020 në shkollat ku plotësohet numri).

Nga data 28.08.2020, në shkollat ku nuk plotësohet numri vazhdon regjistrimi i nxënësve. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 24-31 gusht 2020. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH-it - komisionit për ankesa.

4. Kriteret për regjistrim

4.1. Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- 4.1.1. Nota mesatare të të gjitha klasave (klasat 6-9) (60%) 60 pikë
- 4.1.2. Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasat 6-9) (40%) 40 pikë
- 4.1.3. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkollat e mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritare veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

4.2.Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

4.2.1. Gjinnazi i shkencave natyrore

- Lënda I- Fizikë;
- Lënda II- Kimi;
- Lënda III- Biologji;
- Lënda IV- Matematikë.

4.2.2. Gjinnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore

- Lënda I- Gjuhë amtare;
- Lënda II- Gjuhë angleze;
- Lënda III- Histori;
- Lënda IV- Gjeografi.

4.2.3. Shëndetësi dhe Bujqësi

- Lënda I- Fizikë;
- Lënda II- Kimi;
- Lënda III- Biologji;
- Lënda IV- Gjuhë amtare.

4.2.4.Makinieri,Elektronikë,Gjeodezi,Ndërtimtari, Komunikacion dhe Kimi-Teknologji

- Lënda I- Fizikë;
- Lënda II- Kimi;
- Lënda III- Matematikë;
- Lënda IV- TIK.

4.2.5. Ekonomi

- Lënda I- Gjuhë amtare;
- Lënda II- Gjeografi;
- Lënda III- Matematikë;
- Lënda IV- TIK.

4.2.6. Juridik,Tregëti,Hoteleri dhe Turizëm

- Lënda I- Gjuhë amtare;
- Lënda II- Gjuhë angleze;
- Lënda III- Histori;
- Lënda IV- Gjeografi.

5. Kriteret e përgjithshme për llogaritjen e pikëve

5.1. Nxënësi nga suksesi përgjithshëm e i shkollimit të obligueshëm (klasat 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 60 pikë.Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është($mes.kl.6 + me.kl.7 + mes.kl.8 + mes.kl.9$) $\times 3 = 60$ pikë max.

5.2. Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare,maksimalisht mund t'i fitojë 40 pikë.Shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohet me 2, ($mes.lënda I + mes.lënda II + mes. Lënda III + mes.lënda IV$) $\times 2 = 40$ pikë max.

5.3. Në rast se nuk mund të bëhet pranimi, ngase kandidatët kanë pikë të barabarta, do të merren parasysh edhe këto kritere shtesë.

Suksesi në klasat 1-5 mblihet nota mesatare e 5 viteve dhe pjestohet me 5.

- | | |
|---|--------|
| 5.3.1. Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të diturisë..... | 5 pikë |
| 5.3.2. Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë..... | 5 pikë |
| 5.3.3. Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë..... | 4 pikë |
| 5.3.4. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë..... | 3 pikë |
| 5.3.5. Vendi i parë në gara komunale të diturisë..... | 3 pikë |
| 5.3.6. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë..... | 2 pikë |
| 5.3.7. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë..... | 1 pikë |

5.4. Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabarta. atëherë shkolla për këta kandidatë organizonë vlerësim apo testim.

**PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT E (10-të) PËR VITIN
SHKOLLOR 2020/21, AFATI I GUSHTIT**

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
1	SHML"Xhelal Hajda-Toni	Rahovec	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	6	32	192
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	2	32	64
			Gjithësejtë:	8	32	256

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
2	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	32	96
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	3	32	96
			Makinieri: Automekanik 1	1	28	28
			Gjithësejtë	7		220

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
3	SHML"12 Maji"	Ratkoc	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	32	96
			Gjimnazi i Shkencave Shoqërore	3	32	96
			Juridik: Asistent Juridiku-1	1	28	28
			Gjithësejtë	7		220

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
4	SHMLP"Selajdin Mullaabazi-Mici"	Rahovec	Ekonomi: Kontabilitet-1	1	28	28
			Juridik : Asistent Administratë 1	1	28	28
			Makineri: Instalim i ngrohjes qendrore dhe klimatizimit 1	1	28	56
			Mekatronikë 1	1		
			Bujqësi: Agrobiznes	1	28	28
			Mjekësi: Farmaci -1	1	25	25
			Elektro: Teknik i Informatikës	1	28	28
			Ndërtimtari: Ndërtimtari 1	1	28	28
			Teknologji Ushqimore: Përpunimi i produkteve ushqimore 1	1	28	28
			Gjithësejtë:	9		249

Gjithësejtë për komunën e Rahovecit	31		945
--	-----------	--	------------

Rahovec më:
14.08.2020



Avni Morina, Drejtor
Avni Morina